



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 924/6 prot.

Tiranë, më 30.12.2020

VENDIM
Nr.231, datë 30.12.2020

PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË ZBATIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 195, DATË 18.12.2020, NË INSTITUCIONIN
SHËRBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 195, dt. 18.12.2020, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *“Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2019”*, ku shprehimisht është kërkuar: *“Të intensifikojë procesin e verifikimit të zbatimit të vendimeve pas përfundimit të afatit të paralajmërimit për rregullimin e ligjshmërisë për institucionet që kanë nëpunës të cilët kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare”*, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë proces është përfshirë edhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, institucion varësie i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 4551/1 prot., datë 24.06.2020, nga ana e Ministrisë është raportuar, ndër të tjera, në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik në institucionin Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.

Pas përfundimit të verifikimit, Komisioneri ka dërguar pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, vendimin paralajmërues me Nr. 195, dt. 18.12.2020, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës së konstatuar.

Në kuadër të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, me shkresën nr. 1323/1 prot., datë 24.12.2020, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësit:

- ***** , në pozicionin e punës *“Përgjegjës i Sektorit të Shelfit Kontinental, Drejtoria e Gjeologjisë Detare”*;
- ***** , në pozicionin e punës *“Drejtor, Drejtoria e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë”*;
- ***** , në pozicionin e punës *“Drejtor, Drejtoria e Gjeologjisë”*;
- ***** , në pozicionin e punës *“Specialist, Sektori i Analizave të Ujrave, Drejtoria e Laboratorit të Analizave Kimike”*;
- ***** , në pozicionin e punës *“Specialist Sektori i Monitorimit të Rrjetit Lumor, Drejtoria e Hidrogjeologjisë”*.

2. Pozicionet respektive të punës janë shpallur pozicione të lira, për t’u plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 195, dt. 18.12.2020, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.
3. Të njoftohet për këtë vendim, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha